



Republika e Kosovës - Republika Kosova  
Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborna komisija za žalbe i molbe

A nr. 16/ 2009

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia, në panelin e përbërë nga Osman Tmava, kryesues, Fahredin Ymeri dhe Muharrem Shala, anëtarë, përkitazi me ankesën e z. Agim Kastrati nga Komisioni Zgjedhor Komunal (KKZ) në Kamenicë, në seancën e mbajtur me 2. 11. 2009, mori:

### VENDIM

**Pranohet Ankesa si e bazuar**

KZAP-i konstaton që Partia Demokratike e Kosovës (PDK) e ka shkelur Rregullën Zgjedhore (Nr.13/2009) *Fushata e Zgjedhjeve dhe Njoftimi për Ngjarjet Politike*, ashtu siç kërkohet në nenin 4.2 të kësaj rregullore për çka i shqiptohet gjoba në shumën prej 3400 Euro, të cilën detyrohet të i paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij Vendimi, në Sekretariatit e KZAP-it për tu përcjellë në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

### ARSYETIMI

Z. Agim Kastrati, zyrtarë në KKZ – komuna e Kamenicës ka parashtruar ankesë me të cilën pretendon se PDK, përkatësisht kandidati për kryetar komune i kësaj partie, z. Begzad Sinani, ka bërë shkelje të Rregullës Zgjedhore Nr.13/2009, neni 4.2, duke mbajtur një tubim të pa-autorizuar me simpatizantë dhe anëtarë të këtij subjekti politik, në shtëpinë e kulturës “Isa Kastrati” në Kamenicë.

### FAKTET

Më 19.10.2009, KZAP ka pranuar një ankesë nga zyrtari i ZLE KKZ – Kamenicë, z. Agim Kastrati, në të cilën ka pohuar se subjekti politik PDK ka mbajtur tubim të pa-autorizuar para 150 pjesëmarrësve duke shpalosur programin politik më datë 16.10.2009 në shtëpinë e kulturës “Isa Kastrati” në Kamenicë nga ora 12,15 – 13,00. Në këtë tubim janë përdorur poster, pankarta, flamuj etj.

Për më tepër, ankuesi dëshmon mbajtjen e këtij tubimi, përmes bashkangjites së dokumenteve, respektivisht në të përditshmen Gazetën Info Pres, webfaqen e Radio Premierës dhe foto nga burime tjera.

Në nenin 6.2 të Rregullës Zgjedhore Nr.13/ 2009, kërkohet që Zyrtari Komunal i Zgjedhjeve (ZKZ) ose zyrtarët e Policisë së Kosovës nëse hasin në tubim publik të pa-autorizuar, ata duhet të informojnë KZAP-in për hollësitë e tubimit publik; për kohën, vendin, numrin e pjesëmarrsve në atë tubim publik, për subjektin politik që e mban tubimin publik, si dhe çdo informatë tjetër relevante lidhur me atë tubim publik.

Z. Agim Kastrati, në kapacitet të ZLE i KKZ-së në Kamenicë ka informuar z. Nexhmedin Hyseni, koordinator ne Departamentin për Operacione Zgjedhore (DOZ), më datë 16.10.2009 duke e informuar në lidhje me tubimin e pa-autorizuar publik të subjektit politik PDK, dhe përpjekjet e tij për të njoftuar këtë subjekt politik në lidhje me pasojat në rast të mos respektimit të dispozitave në fuqi. Më tutje, në shkresën informuese ai potencon se Policia ka raportuar rreth tubimit politik të pa-autorizuar përmes zinxhirit të tyre komandues lidhur me kohën, vendin, numrin e pjesëmarrësve të këtij tubimi publik si dhe subjektin politik që mbajti tubimin publik.

KZAP-i më 20 Tetor 2009, pretendimeve, i dhënë mundësi PDK-se që të përgjigjet ndaj supozimeve të paraqitura në ankesë dhe që PDK të ofroj ndonjë informacion që dëshiron në lidhje me ankesën. KZAP-i nuk ka marrë kurrfarë përgjigje nga PDK.

**ANALIZË**

Jurisdiksioni i KZAP’it lidhur me ankesat është caktuar në pajtim me kompetencat e dhëna nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në *Ligjin mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës – LZP* (Ligji nr 03/L- 073) dhe *Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën Kosovës* (Ligji nr 03 / L-072).

Rregulla Zgjedhore Nr. 13/2009, neni 4.2 dhe neni 6.1, parashihet si vijon:

- 4.2 *Subjekti i certifikuar politik që dëshiron të organizojë dhe të mbajë një tubim politik duhet që te Zyrtari Komunal i Zgjedhjeve i asaj komune (ZKZ) ta dorëzojë formularin e plotësuar të Njoftimit për Mbajtjen e Tubimit Politik (FNjMTP), si në Shtojcën 1, së paku shtatëdhjetë e dy (72) orë përpara.*
- 6.1 *Çdo tubim publik i mbajtur pa e dorëzuar FNjMTP-në ose pas refuzimit të FNjMTPsë nga ZKZ-ja ose policia, është i paautorizuar dhe do të konsiderohet shkelje e kësaj Rregulle.*

Në nenin 1.2 të kësaj Rregulle Zgjedhore, tubimi politik përkufizohet si vijon:

1.2 *Me “tubim politik” nënkuptohet tubimi publik që mbahet në hapësira të mbyllura ose të hapura, grumbullimi, diskutimi, marshimi ose debati publik i ideuar me qëllim të përhapjes së porosisë politike për të fituar përkrahjen e votuesve dhe që zhvillohet në përputhje me dispozitat e ligjeve në fuqi.*

4

PDK-ja nuk ka vepruar në pajtim me nenin 4.2 të Rregullës Zgjedhore Nr.13/2009 sepse nuk ka dorëzuar formularin për miratim, të përcaktuar në këtë dispozitë. KKZ e ka refuzuar kërkesën me të drejtë. Përkundër paralajmërimeve, PDK e ka mbajtur tubimin, përkundër faktit që nuk ishin të autorizuar për ta bërë këtë. Kjo është shkelje e Rregullës Zgjedhore Nr.13/2009 ashtu siç saktësohet në nenin 6.1 të kësaj rregulle.

Gjatë përcaktimit të shumës së përshtatshme për gjobitjen e një subjekti politik për shkelje, KZAP ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyrën e shkeljes dhe ndikimin e saj të mundshëm në procesin zgjedhor;
- Sa ishte pesha dhe ashpërsia e shkeljes ka qenë shkelja;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjese në zgjedhjet e mëparshme dhe, prandaj duhet të jetë i njoftuar me detyrat dhe përgjegjësitë në procesin e fushatës;
- Nëse subjekti politik ka kryer shkelje të ligjeve të zbatueshme për zgjedhjet në këto zgjedhje ose në ato të mëparshmet në Kosovë; dhe
- Masat që kanë ndërmarrë ose pranuar subjektet politike, nëse kanë ndërmarrë ose pranuar ndonjë, në mënyre që të mos i shkelin ligjet e zbatueshme për zgjedhjet në Kosovë;
- Ndonjë rrethanë tjetër lehtësuese ose rënduese.

KZAP-i konsideron që PDK-ja nuk e ka marrë parasysh vendimin e ZKZ-së për të mos autorizuar tubimin. KZAP konsideron mbajtjen e tubimit politik si një akt të mosrespektimit të ligjit në fuqi.

KZAP-i tërheq vëmendjen që PDK-ja ka marr pjesë në të gjitha zgjedhjet e kaluara, prandaj anëtarët e PDK-së kanë pasur përvoja të mëhershme dhe duhet ta dinë se para mbajtjes së një tubimi politik duhet të kërkohej leja përkatëse.

PDK-ja nuk ka dorëzuar përgjigje ose nuk ka ndonjë përpjekje për ta mbrojtur sjelljen e saj. Përveç kësaj, ajo nuk ka identifikuar ndonjë masë të cilën e ka ndërmarrë apo miratuar në mënyre që të mos bëjë shkelje të ligjeve të zbatueshme për zgjedhjet në Kosovë. Në mungesë të informatave të tilla, KZAP-i vjen në përfundim se PDK-ja nuk e ka paraqitur asnjë faktor lehtësues në KZAP për shqyrtim.

Për këto arsye, bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës në Prishtinë

A nr. 16/2009 më datën 02.11.2009.

